



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Buletini Nr. 13

Korrik 2017

Hidhen hapat e parë drejt hapjes së Tregut të energjisë elektrike

Vendoste Strukturë e Re Tarifore e energjisë elektrike

Përmbillet transpozimi i pakos së tretë legislative

Licencohen furnizues të rinj

Vazhdojnë investimet në prodhimin e energjisë elektrike

Zhvillohet Procesi i Certifikimit të OST

Vazhdon procesi i Monitorimit të Operatorëve të licencuar

Fjala Hyrëse nga Kryesuesi i Bordit të ZRRE



Arsim Janova
u.d. i Kryesuesit të Bordit të ZRRE

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) sjell Buletinin e trembëdhjetë (13) të saj për të njoftuar me zhvillimet më domethënëse të rregullimit të sektorit të energjisë në vend, që kanë ndodhur përgjatë gjysmës së parë të këtij viti.

Me një përkushtim të madh stafi i ZRRE është angazhuar në amandamentimin dhe kompletimin e legjislacionit sekondar, në mënyrë që të bëhet harmonizimi me ligjet e reja të miratuara nga Kuvendi i Kosovës në vitin e kaluar. Përmes proceseve të diskutimit publik, ZRRE ka nxjerrë dhe amandamentuar mbi 20 rregulla bazë për rregullimin e sektorit të energjisë, përfshirë edhe nxjerrjen e Udhëzuesit për liberalizimin e tregut në Kosovë. Me këtë Udhëzues, ZRRE ka njoftuar të gjithë akterët e sektorit për kushtet e reja të funksionimit të tregut të energjisë, sipas të cilave rregullimi i çmimit të prodhimit të energjisë elektrike ka përfunduar më 31 mars 2017. Si rezultat i këtyre ndryshimeve nga 1 prilli 2017 çmimet e shitjes me shumicë dhe çmimet e furnizimit për konsumatorët me tension të lartë nuk do të përcaktohen më nga Rregullatori por do t'ju nënshtrohen rregullave të tregut të lirë.

Gjithashtu, ZRRE ka arritur të amandamentoit të gjitha licencat duke i përshtatur ato me ligjet dhe rregullat e reja, si dhe ka vazhduar me dhënien e licencave të reja ku vlen të theksohet dhënia e licencave për furnizim me energji edhe për dy operatorë të rinj.

Të gjitha këto aktivitete janë bazë e qëndrueshme rregullative për një funksionim të duhur të tregut të lirë të energjisë.

Si rregullator dhe monitorues i funksionimit të tregut energjetik në vend, ZRRE ka bërë vlerësimin e konkurrencës në tregun e energjisë elektrike në Kosovë dhe ka identifikuar se edhe pse aktualisht janë tre [3] furnizues të licencuar për të furnizuar gjithë tregun me pakicë të energjisë elektrike, deri më tani, dy nga këta furnizues nuk janë ende plotësisht aktiv dhe KESCO ende vazhdon të ketë 100% të pjesëmarrjes në treg. Si pasojë e mungesës së konkurrencës efektive, me qëllim të mbrojtjes së konsumatorëve dhe parandalimit të abuzimit me pozitën dominuese të furnizimit me energji elektrike, Bordi ka vendosur që t'i ngarkoi Obligimin e Shërbimit Publik operatorit të vetëm funksional KESCO, për furnizimin e konsumatorëve që kanë të drejtë në furnizim universal.

Me qëllim të adaptimit të konsumatorëve me rregullat e reja të tregut të lirë dhe në mënyrë që tarifat të jenë sa më të thjeshta për ti kuptuar, dhe mundësuar që më lehtë të kontrollojnë konsumin e tyre në mënyrë që të krahasojnë çmimet që do t'ju ofrohen nga furnizuesit e ndryshëm të cilët pritet të hyjnë në treg, Bordi i ZRRE ka aprovuar ndryshimin e Strukturës Tarifore të energjisë elektrike, e cila është në fuqi që nga 1 prilli 2017. Kjo strukturë nuk paraqet ndryshim nga çmimet mesatare të tarifave të vitit paraprak Rregullativ por është nxjerr si vlerë mesatare nga vlera e përgjithshme e të Hyrave të Lejuara Mesatare të vitit të kaluar për të gjithë koston e sistemit.

I tërë procesi i amandamentimit të legjislacionit sekondar dhe i hapjes së Tregut, përveç që është bërë në transparencë të plotë është zhvilluar edhe në konsultim të ngushtë me Sekretariatën e Komunitetit të Energjisë. Përmes këtyre konsultimeve, ZRRE është siguruar se po ndërtohet një bazë rregullative në përputhje të plotë me direktivat e Bashkimit Evropian.

Po ashtu, edhe përgjatë kësaj periudhe 6 mujore, ZRRE ka vazhduar me proceset e monitorimit të të licencuarve, me qëllim të vlerësimit të nivelit të përmbushjes së obligimeve që dalin nga licencat përkatëse dhe korniza rregullative. Si rezultat i këtyre monitorimeve nga gjetjet e prezantuara për mos përmbushje të kushteve të licencës, Bordi i ZRRE ka shqiptuar një gjobë ndaj Operatorit të Sistemit të shpërndarjes.

ZRRE është e përkushtuar të vazhdojë të përmbush funksionet e saj ligjore me profesionalizëm, duke siguruar të gjithë konsumatorët, operatorët e tregut dhe investitorët potencial se ligjet dhe rregullat e sektorit të energjisë zbatohen nga të gjitha palët, duke ndërtuar dhe zhvilluar një treg funksional të mbështetur në parimet e konkurrencës së lirë të bazuar në Traktatet dhe direktivat e Bashkimit Evropian.

Hidhen hapat e parë drejt hapjes së Tregut të energjisë elektrike

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) në mbledhjen e tij të parë për vitin 2017, të mbajtur më 18 dhe 19 janar, ka aprovuar Udhëzuesin për Liberalizimin e Tregut të Energjisë Elektrike në Kosovë. Ky Udhëzues erdhi si rezultat i ndryshimeve ligjore dhe si nevojë e përshtatjes së legjislacionit sekondar me ligjet e reja të energjisë, të aprovuara nga Kuvendi i Kosovës në korrik të vitit 2016, të cilat janë në përputhje me pakon e tretë për energji të direktivave të Bashkimit Evropian dhe përcaktojnë funksionimin e një tregu të lirë në sektorin e energjisë.

Udhëzuesi, përveç që shërben si udhërrëfyes për veprimet që do të ndërmerren nga të gjithë akterët drejt funksionalizimit të tregut të lirë të energjisë elektrike, po ashtu definon mënyrën, kushtet dhe kohën e hapjes së tregut të energjisë elektrike në Kosovë, në nivelin e Prodhimit dhe Furnizimit të energjisë elektrike.

Definimi i kushteve nga Udhëzuesi do të shërbej si mbështetje për amendamentimin dhe plotësimin e legjislacionit sekondar, të cilin aktualisht është duke e bërë ZRRE.

Me shqyrtimet e reja tarifore që kanë hyrë në fuqi me 1 prill të këtij viti, ZRRE ka përcaktuar vetëm të hyrat e Transmisionit dhe Distribucionit.

Përderisa gjenerimi i energjisë dhe furnizimi i janë nënshtruar tregut të lirë dhe roli i Rregullatorit do të jetë mbikëqyrës, duke siguruar se të gjithë aktorët zbatojnë rregullat e tregut të lirë dhe nuk lidhin marrëveshje në dëm të interesit të konsumatorëve. Me këtë qëllim, tashmë ZRRE ka licencuar edhe dy furnizues të tjerë përveç KESCO Sh.A, HEP sh.a dhe GSA sh.a.

Edhe përkundër se ekziston infrastruktura ligjore, për çdo kompani që është e interesuar të operoj në furnizimin e tregut të energjisë, në vlerësimet e konkurrencës të përgatitura nga ZRRE, është konstatuar që ekziston koncentrim i lartë i një furnizuesi në tregun me pakicë të energjisë elektrike në Kosovë, prandaj për një fazë tranzitore, ZRRE ka vendosur obligimin e shërbimit publik për furnizues me energji elektrike me qëllim të mbrojtjes së konsumatorëve dhe sigurisë së furnizimit.



Tryezë - Liberalizimi i Tregut të energjisë në Kosovë

Gjithashtu Bordi ka shqyrtuar Raportin për Vlerësimin e Konkurrencës në Tregun e Energjisë Elektrike në Kosovë. Raporti ka identifikuar se aktualisht janë tre [3] furnizues të licencuar për të furnizuar gjithë tregun me pakicë të energjisë elektrike, mirëpo deri më tani dy nga këta të licencuar nuk janë plotësisht aktiv dhe KESCO ende ka 100% të pjesëmarrjes në treg.

Si pasojë e mungesës së konkurrencës efektive, me qëllim të mbrojtjes së konsumatorëve dhe parandalimit të abuzimit me pozitën dominuese të furnizimit me energji elektrike, Bordi ka vendosur që ZRRE të përcaktojë Obligimet e Shërbimit Publik për furnizues të ofrimit të Shërbimit Universal me energji elektrike.

Me këtë qëllim, Rregullatori ka përcaktuar masat e nevojshme dhe proporcionale të obligimeve të shërbimit publik, me qëllim të nxitjes të konkurrencës efektive dhe për të siguruar funksionimin e rregullt të tregut të energjisë elektrike.

Për të siguruar ofrimin e shërbimit të furnizimit në kuadër të Shërbimit Universal, me një akt të veçantë, ZRRE ka ngarkuar me obligime të shërbimit publik, Kompaninë Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike – KESCO, sipas kriterëve dhe kushteve të përcaktuara me nenin 5 të Ligjit për Energji Elektrike, duke obliguar atë që të ofrojë furnizim me energji elektrike konsumatorëve që gëzojnë të drejtën e furnizimit në kuadër të shërbimit universal.

Ndryshimi i Strukturës Tarifore të energjisë elektrike

Në mars të vitit 2017 Bordi i ZRRE ka iniciuar ndryshimin e Strukturës Tarifore të energjisë elektrike.

Pas zhvillimit të procesit të diskutimit publik Struktura e Re Tarifore, është aprovuar nga Bordi i ZRRE dhe si e tillë është në fuqi që nga 1 prilli 2017.

Vendimi për ndryshimin e strukturës tarifore ka për qëllim që tarifatat të jenë sa më të thjeshta për ti kuptuar, për të gjithë konsumatorët, dhe të krijoj përshtatje të sektorit me rrethanat e reja të krijuara nga kërkesat ligjore për liberalizim të tregut. Përmes këtij thjeshtësimi, ZRRE synon të ju mundësojë konsumatorëve që më lehtë të kontrollojnë konsumin e tyre dhe të mund të krahasojnë më mirë çmimet që ju ofrohen nga furnizuesit e ndryshëm që pritet të hyjnë në treg.

Si rezultat i këtij ndryshimi të Strukturës Tarifore të gjithë konsumatorët fundorë do të kenë një çmim të pandryshuar në aspektin sezonal, për çdo kWh të shpenzuar. Përveç kësaj, konsumatorët familjar nuk do të paguajnë më sipas blloqeve tarifore në bazë të nivelit të konsumit.

Me strukturën e re, tek të gjithë konsumatorët fundorë do të aplikohen vetëm tarifatat ditore prej **7 cent për kWh**, për tarifën e lartë dhe **3 centë për tarifën e ulët**. Në këtë mënyrë do të ketë një nxitje për konsumatorët që të zhvendosin një pjesë të konsumit nga koha e pikut (ditën) në kohën kur ngarkesa në sistem është më e ulët (natën). Nga 1 prill deri 30 shtator tarifa gjatë ditës do të jetë tarifë e lartë që aplikohet në mes të orës 08:00h – 23:00h, ndërsa gjatë natës do të jetë tarifa e ulët e aplikueshme prej orës 23:00h – 08:00h. Përderisa nga 1 tetori deri me 31 mars, tarifa e lartë do të jetë prej 07:00h – 22:00h dhe tarifa gjatë natës do të jetë në mes të orës 22:00h – 07:00h.

Vlen të theksohet se Çmimet e Strukturës së re tarifore paraqesin çmimet mesatare të tarifave të vitit paraprak (viti Rregullativ 2016).

Procesi i ndryshimit të strukturës është zhvilluar në transparencë të plotë dhe me përfshirjen e të gjitha palëve të interesuara.



Seancë Publike - Prezantimi i Propozimit të Strukturës së Re

Si pjesë e këtyre diskutimeve për Propozimin e Strukturës Tarifore të energjisë elektrike, përfaqësues të ZRRE, me kërkesë të Komisionit Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri kanë prezantuar Propozimin e Strukturës Tarifore dhe ndikimet që do të ketë kjo strukturë tek konsumatorët e të gjitha kategorive. Gjatë takimit, anëtarët e Komisionit kanë kërkuar nga përfaqësuesit e ZRRE-së, të ju prezantohen disa simulime të faturave të konsumatorëve nga grupe të ndryshme të konsumit, në mënyrë që të informohen më në detaje me ndikimet që mund të kenë këto grupe nga ndryshimet e strukturës tarifore të propozuar.



Prezantimi i Propozimit të Strukturës para Komisionit Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Energjetikë Tregëti dhe Industri

Me këtë qëllim ZRRE ka mbajtur edhe një seancë dëgjimore të hapur me të gjitha palët e interesuara ku janë pranuar komentet dhe janë diskutuar ndikimet e strukturës së re tarifore.

Po ashtu, ZRRE ka pranuar komente nga palët e interesuara përmes postës elektronike dhe të gjitha komentet kanë qenë pjesë e shqyrtimit të Bordit.

ZRRE ka vendosur që të rishqyrtoj strukturën aktuale tarifore duke pasur si synim që tarifatat e ardhshme të jenë sa më të thjeshta për ti kuptuar për të gjithë konsumatorët dhe të bëhen përshtatjet e nevojshme me rrethanat e reja të krijuara në sektor pas kërkesave ligjore për liberalizim të tregut. Përmes këtij thjeshtësimi, ZRRE synon të ju mundësojë konsumatorëve krahasim më të lehtë të çmimeve të ofruara nga furnizuesit e ndryshëm që pritet të hyjnë në tregun e energjisë elektrike në vend.



Transpozimi i Pakos së Tretë

Kosova si palë nënshkruese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë (TKE), është zotuar që të aplikojë legjislacionin e Bashkimit Evropian (BE).

Në verën e viti të kaluar, është nxjerr nga Kuvendi i Kosovës Pakoja e tretë e ligjeve të energjisë, e cila është në përputhje të plotë me direktivat e Bashkimit Evropian. ZRRE brenda afateve të përcaktuara me ligj ka amendamentuar legjislacionin sekondar që rregullon sektorin e energjisë në mënyrë që ta përshtat me këto ligje dhe me direktivat tjera përkatëse të BE-së.

I tërë ky proces është zhvilluar në konsultim me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë në Vjenë dhe me të gjitha palët e tjera të involvuara në sektor.

Rregullat amendamentuara me Pakon e tretë Legjislative

Rregulla për Furnizuesin e mundësisë së fundit

Rregulla për vendosjen e të hyrave për Furnizuesin me Shërbim Universal

Parimet për përcaktimin e Tarifave për shfrytëzimin e Sistemit të Transmetimit dhe Tregut dhe Taksave të Kyçjes

Parimet për përcaktimin e Tarifave për shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes dhe Taksave të Kyçjes

Rregulla për Ndërrimin e Furnizuesit

Rregulla për Vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike

Rregulla për Skemën Mbështetëse

Rregulla e procedurës së autorizimit për ndertimin e kapaciteteve të reja gjeneruese

Rregulla për vendosjen e çmimeve të gjenerimit (Rregulla për Çmimet e Gjenerimit)

Rregulla për të hyrat e lejuara maksimale për operatorin e sistemit të shpërndarjes (Rregulla për të hyrat e OSSH -së)

Rregulla për të hyrat e lejuara maksimale për operatorin e sistemit të transmetimit dhe të tregut (Rregulla për të hyrat e OST/OT -së)

Udhëzuesi për Liberalizimin e Tregut të energjisë elektrike në Kosovë

Udhëzimet Rregullatore të Kontabilitetit

Rregulla për Taksat

Rregulla për Informatat Konfidencionale

Rregulla për Masat Administrative dhe Gjobat

Rregulla për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë

Rregulla për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji

Rregulla për Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë

Rregulla për Shkyçje dhe Rikyçje të Konsumatorëve në Sektor të Energjisë në Kosovë

Rregulla për certifikimin e operatorëve të sistemit të transmetimit

Rregulla për Vlerësimin e Projekteve Kapitale në Rrjetin e Transmetimit dhe Shpërndarjes në Sektorin e Energjisë Elektrike

Modifikimet e Licencave

Gjatë kësaj periudhe Rregullatori ka modifikuar Licencat si në vijim:

Licencat për prodhim të energjisë elektrike

KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS (KEK SH.A).TC

KOSOVA A

"KELKOS ENERGY" SH.P.K

NDËRMARRJA HIDROEKONOMIKE "IBËR LEPENC" SH.A.

Licenca Për Bashkëprodhim Të Energjisë Elektrike Dhe Termike

KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS (KEK SH.A).TC

KOSOVA B

Licenca për Operatorin e Tregut të Energjisë Elektrike

OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMISIONIT DHE TREGUT (KOSTT) SH.A

Licenca për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes

KOMPANISË KOSOVARE PËR DISTRIBUIM DHE FURNIZIM ME ENERGI ELEKTRIKE – SH.A.

Licenca për Operatorin e Tregut të Energjisë Elektrike

OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMISIONIT DHE TREGUT (KOSTT) SH.A

Licenca për Furnizim Me Energji Elektrike

"KOSOVO ELECTRICITY SUPPLY COMPANY" (KESC) J.S.C

Licencat për furnizim me shumicë (tregtim) të energjisë elektrike:

"Energio Supplier" SH.P.K.

"PETROL TRADE SLOVENIJA" L.L.C.

"FUTURE ENERGY TRADING" SH.P.K

"GSA ENERGI" SH.P.K.

"PAN INTERTRADE" SH.P.K.

"EDS International KS" L.L.C

"AXPO KOSOVO" L.L.C.

"ENERGY FINANCING TEAM" L.L.C.

"EVN TRADING" L.L.C.

"MCM COMMODITIES" SH.P.K

"DANSKE COMMODITIES KOSOVO" SH.P.K

Licencat për prodhim të energjisë termike

Ndërmarrja Publike "Termokos" SH.A

"Ngrohtorja së Qytetit" SH.A

Licenca për Shpërndarje të Energjisë Termike

Ndërmarrja Publike "Termokos" SH.A

"Ngrohtorja së Qytetit" SH.A

Licenca Për Furnizim Me Energji Termike

Ndërmarrja Publike "Termokos" SH.A

"Ngrohtorja së Qytetit" SH.A

Vendimet e Bordit të ZRRE për periudhën 1 janar - 31 qershor 2017

Vendimet për Licencim të aktivitetit të furnizimit me shumicë (tregtimit) të energjisë elektrike në Kosovë:

V_894_20017 – për "Interenergo d.o.o-Kosova" SH.P.K.

V_911_2017 – për "MTSP KOSOVO L.L.C"

Vendimet për të hyrat maksimale, çmimet dhe tarifat

V_903_2017 – për tarifat e konsumatorëve me shërbime universale të KESCO

V_907_2017– për të Hyrat Maksimale të Lejuara (MAR) KOSTT

V_908_20017 – për të Hyrat Maksimale të Lejuara (MAR) KEDS

V_909_2017 – për azhurnimet për Investime Kapitale, për KEK SH.A.

V_912_2017 - Aprovimi i Metodologjisë së Taksave të Kycjes në Rrjetin e Transmetimit

V_913_2017 – për tarifat e shfrytëzimit të sistemit të transmetimit.

V_914_2017 – për tarifat e shfrytëzimit të sistemit të shpërndarjes.

Vendimet mbi njoftimin për autorizimet preliminare

V_895_2017 – për "Hidro Forca" Sh.p.k. HC "Strazha", Kaçanik.

V_896_2017 – për "Security Team Kabashi K" Sh.p.k. HC "Erenik", Junik.

V_897_2017 – për "Monten" Sh.p.k., HC "Llapi 1", Podujevë.

V_898_2017 – për "Monten" Sh.p.k., HC "Llapi 2", Podujevë.

V_899_2017 –për "Hidrocom" Sh.p.k.,HC "Kaqandoll", Podujevë.

V_900_2017 –për "PRISHTINA - ENERGY" SH.P.K., prodhim i energjisë elektrike nga era, "Wind Park-Koznica" Novobërdë.

V_917_2017 – për "Puna" Sh.p.k., HC "Radesha 1", Dragash.

V_918_2017 – për "Puna" Sh.p.k., HC "Radesha 2", Dragash.

Vendimi për shtyrje të afatit të vlefshmërisë së vendimit mbi Njoftimin e Autorizimit Preliminar:

V_883_2017 – për "Çeta – General Invest Group" Sh.p.k.

V_884_2017 – për "AFA Energy" SH.P.K.

V_885_2017 – për "AFA Energy" SH.P.K.

V_893_2017 – për NPN "Renelual Tahiri" Sh.p.k.

Vendimet për lëshim të Autorizimin Final

V_880_2017 – për " 2 Korriku" SH.P.K (HC "Soponica")

V_881_2017 – për "Eurokos JH SH.P.K (HC "Brod").

V_882_2017 – për "Eurokos JH SH.P.K (HC "ZK Gllloboqic").

V_889_2017 – për "Hidro Line" SH.P.K. (HC "Albaniku").

V_890_2017 – për "Hidro Line" SH.P.K. (HC "Albaniku 4").

V_891_2017 – për NPN "Renelual Tahiri" SH.P.K. (HC).

V_906_2017 – për N.T.SH. Elting.

Vendimet për modifikim të Autorizimit Final

V_892_2017 – "EKO -ENERGJI" Sh.p.k., për Hidrocentralin në Lumin Morava e Binçës HC "Binça".

V_919_2017 për "Hidroenergji" Sh.p.k., për Hidrocentralin në Lumin Lepenc.

Vendime të ndryshme

V_904_2017 – për Plani Zhvillimor i Transmetimit 2017–2026.

V_905_2017 – për dënimin me gjobë të KEDS lidhur me ndërprerjet gjatë muajit tetor-nëntor 2016.

V_916_2017 – për vendosjen e shërbimit publik të licencuarit për furnizim me energji elektrike.



Procesi i Certifikimit të OST

ZRRE ka iniciuar procesin e Certifikimit të Operatorit të Sistemit të Transmisionit (OST) – KOSTT.

Certifikimi i OST-ve kërkohet me qëllim të sigurimit që OST funksionet e tij i realizon në mënyrë të pavarur nga çfarëdo biznesi tjetër në sektorin e energjisë dhe rrjedhimisht të sigurohet që OST si i tillë ofron qasje të lirë dhe jodiskriminuese në rrjetin e transmetimit për të gjithë akterët që veprojnë në sektor, duke siguruar kështu funksionim të lirë të tregut të energjisë elektrike në vend.

Certifikimi është proces sipas të cilit ZRRE-ja konfirmon se ka ndarje të mjaftueshme të kontrollit mbi OST-në në njëri anë, dhe mbi prodhimin dhe/apo furnizimin në anën tjetër dhe që kontrolli i ndërmarrjes së energjisë është në pajtueshmëri me dispozitat përkatëse të shturjes.

Me këtë qëllim me 16 qershor 2017 përfaqësues të Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregu-KOSTT sh.a kanë prezantuar para ZRRE aplikacionin për Certifikimin e KOSTT.

ZRRE ka kërkuar që aplikacioni të plotësohet edhe me disa të dhëna shtesë të cilat janë të nevojshme për definimin e pronësisë së asetëve të OST si dhe çështje të tjera përkatëse për këtë proces.

Duke qenë kërkesë e dal nga direktivat e BE-së, edhe procesi i Certifikimit është duke u përcjell dhe koordinuar me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë dhe sapo të kompletohet Bordi do të merret vendimi final.

Proceset e Monitorimit të Operatorëve

Sipas nenit 54 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, Zyrës së Rregullatorit për Energji i është dhënë e drejta që të ushtrojë mbikëqyrjen në implementimin e akteve, vendimeve dhe udhëzimeve të lëshuara nga ZRRE-ja.

Me këtë qëllim ZRRE vazhdimisht zhvillon procese të monitorimit në mënyrë që të sigurohet se operatorët e licencuar janë duke operuar në përputhje me kushtet e licencave të tyre dhe me ligjet dhe rregullat që rregullojnë sektorin e energjisë në vend.

Një proces i jashtëzakonshëm i monitorimit është zhvilluar për të monitoruar ofrimin e shërbimeve për konsumatorët dhe ndërprerjet e furnizimit me energji nga Operatori i Shpërndarjes (OSSH). Ky proces ka filluar më 10 gusht 2016, kur Bordi i ZRRE-së ka themeluar Grupin punues për Monitorimin e KESCO-s dhe KEDS-it në fushën që mbulon ofrimin e shërbimeve për konsumatorët.

Pas përfundimit të procesit të monitorimit Bordit i është dorëzuar raporti nga Komisioni monitorues dhe bazuar të Bordit ka njoftuar operatorin me shkeljet e gjetura si dhe ka kërkuar sqarime në lidhje me to. Pas marrjes së përgjigjeve nga Operatori i Shpërndarjes, Bordi në takimin e tij të V, të mbajtur me 31 mars 2017, ka konstatuar se Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) nuk ka arritur të dëshmojë se të gjeturat nga monitorimi i ZRRE-së nuk janë të sakta dhe ka vendosur që duke u bazuar në Rregullën për Masat Administrative dhe Gjobat të shqiptojë dënim me gjobë në vlerë prej dyzet e pesë mijë (45.000) euro.

Si pjesë e proceseve të rregullta monitoruese ZRRE në qershor të këtij viti ka iniciuar proceset e reja të monitorimit në të cilat janë të përfshirë të gjithë operatorët e licencuar që ofrojnë shërbime të energjisë. Pas përfundimit të monitorimeve ZRRE dërgon për komentim dhe publikon në faqen e saj elektronike www.ero-ks.org të gjitha raportet.



Prishtinë, 16 qershor 2017 - Prezantimi i aplikacionit për Certifikim të KOSTT

Zyra e Rregullatorit për Energji

Rruga: Dervish Rozhaja nr. 12

Prishtinë 1000, Kosovë

Tel: +381 (0) 38 247 615

Mob: +386 (0) 49 78 70 80

Fax: +381 (0) 38 247 620

Email: info@ero-ks.org

Web: www.ero-ks.org

Për Konsumatorë:

Tel: +381 (38) 247 615 lok. 116

Fax: +381 (0) 38 247 620

Email: ankesa.dmk@ero-ks.org

Për çështje Ligjore, Licencim, BRE/Autorizim:

Tel: +381 (38) 247 615 lok. 114, 117, 118

Fax: +381 (0) 38 247 620

Email: legal-licensing@ero-ks.org